

Antistatik, Elektroskarkues, Elektropërçues!

Për, pothuajse, asnjë temë tjetër në treg, nuk ka aq shumë konfuzion si për temën e sjelljes elektrostatiske të dyshemeve. Fenomeni i ngarkimit elektrostatik krijohet më së shumti, kur materiale me gjendje të ndryshme tensioni përmes fërkimit ngarkohen.

Kjo vërehet më së shumti në lagështi të ulët të ajrit, e cila paraqitet në klimë kontinentale gjatë dimrit. Në stinat e tjera me lagështi mbi 50% ngarkimi është i rrallë.

Antistatika

Dyshemetë antistatike kanë vetinë, që ngarkime apo shkarkime të ndjeshme në persona nuk paraqiten. Kjo sigurohet përmes përçueshmërisë horizontale të dyshemesë. Për këtë arsye dyshemeve elastike dhe tekstile i shtohen elemente përçuese. Në normen PrEN 14041:2000 gjendet definicioni: Dysheme tekstile quhen antistatike, nëse në një temperaturë prej 23°C dhe në lagështi relative të ajrit prej 25%, tensioni i trupit nuk është më tepër se 2kV.

Shkarkimi

Përveq sjelljes antistatike të dyshemesë, përçueshmëria ka edhe kuptimin, t'i largon ngarkesat nga persona të ndryshëm, të cilat nuk rrjedhin nga dyshemeja. Dysheme tekstile quhen shkarkuese, nëse sipas ISO 10965 rezistenca e përçarjes nuk është më e madhe se $10^9 \Omega$.

Përçueshmëria

Dysheme tekstile quhen përçuese, nëse sipas ISO 10965 rezistenca e përçarjes prej $10^6 \Omega$ nuk kalohet.

Normat dhe definicionet e rëndësishme

Elektro Antistatik

Dyshemetë quhen antistatik, nëse në gjendje të shtruar kanë ngarkesë personale më pak se 2kV (Norma: PrEN 14041:2000)

Shkarkues Elektrostatik:

Dyshemetë quhen elektroskarkues, nëse në gjendje të shtruar kanë rezistencë të përçarjes më pak se $10^9 \Omega$ (Norma: IEC 1340-4-1).

Elektropërçues:

Dyshemetë tekstile konsiderohen përçuese, nëse sipas ISO 10965 rezistenca e përçarjes nuk kalon mbi $10^6 \Omega$

Rezistenca sipërfaqësore

Rezistenca sipërfaqësore të një dysheme tekstile matet ndërmjet dy elektrodave të vendosura në dysheme në distancë prej 500mm.

Rezistenca depërtuese:

Rezistenca depërtuese matet ndërmjet sipërfaqes dhe shpinës të një mostre materiali të pashtuar.

Normat e rëndësishme të testimit:

Test i shkëlqes: EN 1815 apo ISO 6356


Rezistenca sipërfaqësore dhe depërtuese: ISO 10965

Rezistenca e tokëzimit: IEC 1340-4-1

Norma të domosdoshme të rëndësishme:

PrEN 1307:2002 EN 1307:1997 PrEN 14041:2001

Simbol shtese në „Certificate of Quality“



Është edhe e rëndësishme qëndrueshmëria afatgjate e sjelljes antistatike, posaqërisht rezistenca ndaj pastrimit të përsëritshëm. Kjo kërkesë merret parasysh në normën e fazës fillestare PrEN 1307-2002 dhe kështu pritët nga të gjitha dyshemetë tekstile të pajisura me simbolin antistatik. Shoqëria europiane e tepihëve (ETG) tashmë ofron këtë veti të sigurisë: Si simbol „Antistatik“ në Teppich-Siegel „Certificate of Quality“.

Pasiguri përmes deklaratave të gabuara

- „Të gjitha dyshemetë tekstile sot janë praktikisht antistatike“:

Kjo deklaratë është e pavërtetë, sepse ligjërisht nuk ekzistojnë vlerat minimale. Nëse kërkohet Antistatika, duhet të kihet parasysh në vetite shtesë.

- „Dyshemetë e leshta janë gjithmonë antistatike“:

Edhe kjo deklaratë nuk qëndron. Leshi mund të ruaj deri në 30% ujin, pa u ndier i lagësht. Dyshemetë (veshjet) e leshit në lagështi relative të ajrit rreth 50% paraqesin automatikisht sjellje antistatike. Nëse ato humbasin këtë veti për shkak të thatësisë, ndihmon spërkatja me pak lagështi.



PROFLOOR

Zahir Pajaziti 48 KS-20000 Prizren

T-F: +383 (0)29 233 769

unihem@gmail.com

M: +383 (0)49 303 769

www.dyshemeja.com